



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:083753

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05574365

**C.nr.386/22**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, nëpërmjet gjyqtarit Robert Tunaj, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me Sek. Juridike F. Kabashi, në çështjen juridike të paditësve: S.M, G.H, A.Z dhe D.B, që të gjithë të punësuar në SH.F.M.U “Migjeni” në fshatin Gj, K. S, të cilët me autorizim i përfaqëson av. I. XH. K nga S, kundër të paditurës K e S–D e A, të cilën e përfaqëson, përfaqësuesi ligjor A. B, me objekt kontesti shpërblimin e inflacionit në pagë, gjykata me datë 15.04.2024, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: S.M, G.H, A.Z dhe D.B, që të gjithë të punësuar në SH.F.M.U “Migjeni” në fshatin Gj, K. S.
- II. DETYROHET** e paditura K e S – D e A, që në emër të diferencës së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit prej periudhës 26.04.2019 deri me datë 31.12.2021, të paguajë shumat dhe atë:

**Për paditësin S. M:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 63.15 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 6.23 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 106.03 euro, **në shumën totale prej 175.41 euro;**

**Për paditësin G. H:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 113.20 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11.18 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 190.07 euro, **në shumën totale prej 314.45 euro;**

**Për paditësin A. Z:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 89.59 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 8.84 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 150.43 euro, **në shumën totale prej 248.86 euro;**

#### **Për paditësin D. B:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 108.84 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 10.75 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 182.75 euro, **në shumën totale prej 302.34 euro;**

Të gjitha këto në shumë totale **1.041,06€** me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (26.04.2022), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**III. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket periudhës kohore për vitin 2017 , 2018 e deri me 25.04.20219, për shkak të *parashkrimit*.

**IV. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Suharekës, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 280 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

### **Arsyetim**

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me datë 26.04.2022, kanë parashtruar padi kundër K së S, D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin në pagë nga shkalla e inflacionit.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës, K e S – D e A, me datë 02.11.2023 pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigje në padi, në të cilën ka theksuar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e pagës, konform shkallës së inflacionit, marrë për bazë edhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme, por ka kërkuar që të refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë sa i përket parashkrimit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht **e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, i aprovoi kërkesëpaditë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i paditësve, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e inflacionit në pagë, i ka bashkëngjitur padisë listën e pagave dhe kontratat e punës, përkatësisht për paditësin Sadik Muharremaj kontrata me numër protokollit 127, për paditësin Gani Hajdaraj kontrata me numër protokollit 94, për paditësin Ali Zenelaj kontrata me numër protokollit 50 si dhe për paditësin Dardan Berisha kontrata me numër protokollit 90.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve, që të ia kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar normës së inflacionit për vitin 2019 - 2.7 %, për vitin 2020 - 0.2 % dhe për vitin 2021 - 3.4 %, duke u bazuar në dispozitat e nenit 35, pika 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, që parashihet se “*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës*”.

Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtrësja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Ndërkaq, gjykata vendosi lidhur me shumën duke llogaritur për periudhën kohore nën marrëdhënie të punës për secilin paditës dhe secilin vit, marrë për bazë shkallën e inflacionit, ashtu që:

#### **Për paditësin S. M:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, duke llogaritur 2.7% shkallën e inflacionit, shumëzuar me pagën neto 259.89 euro, shuma e përgjithshme 63.15€;

Për vitin 2020, shkalla e inflacionit 0.2% shumëzuar me pagën neto 259.89 euro, shuma e përgjithshme 6.23€;

Për vitin 2021, shkalla e inflacionit 3.4 %, shumëzuar me pagën neto 259.89 euro, shumën prej 106.03€, **në shumën totale prej 175.41 euro;**

#### **Për paditësin G. H:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, duke llogaritur 2.7% shkallën e inflacionit, shumëzuar me pagën neto 465.86 euro, shuma e përgjithshme 113.20€;

Për vitin 2020, shkalla e inflacionit 0.2% shumëzuar me pagën neto 465.86 euro, shuma e përgjithshme 11.18€;

Për vitin 2021, shkalla e inflacionit 3.4 %, shumëzuar me pagën neto 465.86 euro, shumën prej 190.07€, **në shumën totale prej 314.45 euro;**

#### **Për paditësin A. Z:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, duke llogaritur 2.7% shkallën e inflacionit, shumëzuar me pagën neto 368.72 euro, shuma e përgjithshme 89.59€;

Për vitin 2020, shkalla e inflacionit 0.2% shumëzuar me pagën neto 368.72 euro, shuma e përgjithshme 8.84€;

Për vitin 2021, shkalla e inflacionit 3.4 %, shumëzuar me pagën neto 368.72 euro, shumën prej 150.43€, **në shumën totale prej 248.86 euro;**

#### **Për paditësin D. B:**

Për periudhën prej datës 26.04.2019, deri me datë 31.12.2019, duke llogaritur 2.7% shkallën e inflacionit, shumëzuar me pagën neto 447.94 euro, shuma e përgjithshme 108.84€;

Për vitin 2020, shkalla e inflacionit 0.2% shumëzuar me pagën neto 447.94 euro, shuma e përgjithshme 10.75€;

Për vitin 2021, shkalla e inflacionit 3.4 %, shumëzuar me pagën neto 447.94 euro, shumën prej 182.75€, **në shumën totale prej 302.34 euro;**

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësve është dorëzuar më 26.04.2022, ndërsa kërkesëpadia e paditësve përfshin periudhën kohore për vitet 2017-2021. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa përkompensimin e pagës konform shkallës së inflacionit përgjatë viteve 2017 dhe 2018 është parashkruar.

Gjykata është bazuar në mendimin juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023 në cilin parashihet se “*Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit, marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës*”, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë për 4 paditës shumën prej 260 euro dhe shumën prej 20 euro në emër të taksës gjyqësore apo në shumë të përgjithshme prej 280 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.386/2022 data 15.04.2024**

**Gjyqtari  
Robert Tunaj**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.